

**L I G J**  
**Nr.8104, datë 28.3.1996**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7933, DATË 17.5.1996 “PËR PUNËT PUBLIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Në ligjin nr.7933, datë 17.5.1995 “Për punët publike” bëhen këto ndryshime:

- Neni 1 ndryshohet si vijon: “Anëtarëve të familjeve në ndihmë ekonomike dhe individëve të përfshirë në skemat e pagesës së papunësisë u ofrohet pjesëmarrja në punët publike”.

- Neni 2 ndryshohet si vijon: “Punët publike, në kuptimin e këtij ligji, janë punë të përkohshme që realizohen me pjesëmarrjen e anëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, si dhe të individëve të cilët trajtohen nga skemat e pagesës së papunësisë, që organizohen nga shteti për ndërtim elementesh të thjeshta të infrastrukturës, riparime, pastrime dhe mirëmbajtje objektsh të ndryshme”.

- Neni 3 ndryshohet si vijon: “Anëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe individëve të përfshirë në skemat e pagesës së papunësisë, të cilët refuzojnë pjesëmarrjen në punët publike të ofruara, u ndërpritet ndihma ekonomike ose pagesa e papunësisë”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.1450, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha**